



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë më 17 tetor 2019
Nr. Ref.:RK 1448/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 83/18

Parashtrues

Ivica Milošević

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-I-17-0402, të 22 shkurtit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ivica Milošević nga Graçanica (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Fehmi Shala, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), AC-I-17-0402, të 22 shkurtit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të vendosë masën e përkohshme.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 27 [Masat e përkohshme] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] dhe 56 [Kërkesa për masë të përkohshme] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 qershor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 16 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Snezhana Botusharova i Almiro Rodrigues. Më 26 qershor 2018, u përfundoi mandati gjyqtarëve: Altay Suroy dhe Ivan Čukalović.
8. Më 9 gusht 2018, Presidenti i Republikës së Kosovës emëroi gjyqtarët e rinj: Bajram Ljatifi, Safet Hoxha, Radomir Laban, Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
9. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Gresa Caka-Nimani dhe Bajram Ljatifi.
10. Më 7 shtator 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 10 shtator 2019, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 14 shtator 1982, Miroslav Milošević (në tekstin e mëtejme: babai i parashtruesit të kërkesës) lidhi Kontratën mbi ndërrimin vullnetar të paluajtshmërive [Vr. nr. 3008/82] me Ndërmarrjen Shoqërore KBI „Kosova-Export“ (në tekstin e mëtejme: KBI „Kosova-Export“). Objekti i kontratës ishte ndërrimi i ngastrës kadastrale (1338/2) në pronësi të parashtruesit të kërkesës me ngastrën kadastrale (1692/2) në pronësi të KBI „Kosova-Export“.
13. Pas kësaj, KBI „Kosova-Export“ në bazë të kontratës në fjalë hyri në posedim të ngastrës nr. 1338/2 dhe e zbatoi ndryshimin e pronësisë në librat kadastral. Megjithatë, babai i parashtruesit të kërkesës nuk e zbatoi ndryshimin e pronësisë në ngastrën nr. 1692/2 në librat kadastral.
14. Më 10 dhjetor 2012, babai i parashtruesit të kërkesës paraqiti në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së) padinë për anulimin e Kontratës Vr. nr. 3008/82, me propozim që të caktohet masa e përkohshme dhe të parandalohet kështu Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP) që të shes pronën në pronësi të KBI „Kosova-Export“, konkretisht, ngastrën kadastrale nr. 1338/2.
15. Më 17 prill 2013, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktvendimit C-III-12-1986, miraton propozimin e babait të parashtruesit të kërkesës për lëshimin e urdhrit paraprak gjyqësor, duke arsyetuar:

“Paditësi ka paraqitur prova prima facie ku thuhet se padia e tij nuk është haptazi tërësisht e pabazuar dhe e drejta e tij e pronësisë nëse ekziston është në rrezik, e cila mund të konsiderohet si dëm i pariparueshëm i cili nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar nëse aset i në fjalë bartet tek pala e tretë gjatë procesit të privatizimit apo likuidimit. Prandaj, kërkesa e paditësit për lëshimin e urdhërit paraprak gjyqësor paraqitet si e bazuar deri në zgjidhjen e padisë nga Kolegji për pronësinë apo Kolegji i Likuidimit varësisht nga hulumtimi nëse ky aset i takon pjesës së ndërmarrjes në likuidim”.

16. Më 2 maj 2013, AKP paraqiti ankesë kundër Aktvendimit (C-III-12-1986) të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së të 17 prillit 2013, duke kërkuar që ky Aktvendim të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.
17. Më 28 janar 2014, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, përmes Aktvendimit AC-I-13-0053, refuzoi ankesën e AKP-së dhe vërtetoi vendimin (C-III-12-1986) e Kolegjit të Specializuar të 17 prillit 2013.
18. Më 3 prill 2015, babai i parashtruesit të kërkesës ka ndërruar jetë dhe pas kësaj, në bazë të Aktvendimit mbi trashëgiminë, parashtruesi i kërkesës është shpallur për trashëgimtarin e vetëm.
19. Më 21 qershor 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, përmes Aktgjykimit C-III-12-1986, refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës për anulimin e kontratës, duke arsyetuar:

“Padia ka të bëjë me anulimin e kontratës të lidhur në vitin 1982, bazuar në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve (RSFJ, 29/78). Afati i parashkrimit për padinë është 10 vjet (neni 14 i Ligjit për parashkrimin e kërkesave). Nga viti 1982 kanë kaluar më shumë se 34 vite. Prandaj koha për parashtrimin e një padie të tillë ka kaluar”.

20. Më 11 qershor 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të ligjit procedural dhe material dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.
21. Më 22 shkurt 2018, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit (AC-I-17-0402), refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe mbështeti Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar. Në arsyetimin e Aktgjykimit, Kolegji i Apelit, ndër të tjera, theksoi: *“paditësi gjithashtu nuk ka arritur t’i përmbahet afatit të paraparë me nenin 371 të LPK-së për të kërkuar ndërprerjen e kontratës. [...] Paraardhësi i parashtruesit të padisë nuk ishte në gjendje të kontrollonte pronën të cilën e fitoi me kontratë, siç pohonte edhe vetë paditësi, prona e cila ishte objekt i aktgjykimit, është bartur me aktgjykimin e gjykatës mbi personin fizik M.Ž., i cili më pas ia shiti këtë pronë Sh.H. Neglizhenca për regjistrimin me kohë të pronës së fituar nga paraardhësi i paditësit nuk mund t’i atribuohet NSH-së, siç synon paditësi në ankesën e tij t’ia atribuojë përgjegjësinë NSH-së. Përveç kësaj, tjetërsimin e kësaj ngastre personave të tretë nuk e kishte bërë NSH përmes kontratës së shitblerjes, por, siç deklaroi paditësi, gjykata në vendimin e saj vendosi që kjo pronë i takon M.Ž.”*

Pretendimet e parashtruesit

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta e pronës e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.
23. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon: *“në rastin konkret kemi një mospërmbushje të plotë të detyrimeve nga kontrata, te pala paditëse ekzistojnë arsye ligjore për shpalljen nule, të kontratës nga neni 103 të LMD, ku e drejta në paraqitjen e nulitetit në bazë të dispozitës së nenit 110 të LMD, nuk shuhet fare. Kjo kontratë është nule nga fakti se aktualisht kjo është në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës së detyrimeve, në rastin konkret me nenin 10 të LMD, që flet për barabarësi të palëve dhe nenin 15 të LMD, që flet për parimin e vlerës së njëjtë të prestimeve të dhëna. Në rastin konkret palët janë të pabarabarta, dhe kemi situatën kur njëra palë kontraktuese ka marr një të mirë materiale, kurse nuk e ka kryer detyrimin që palës tjetër t’ia jap ekuivalentin e asaj që ka marrë, kjo do të thotë se kemi shkelje të këtyre dy parimeve themelore, dhe si e tillë kjo kontratë nuk mund të qëndroj”.*
24. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon: *“paditësi është privuar nga e drejta e pronësisë, pa fajin e tij. Konsiderojmë, se mos regjistrimi i pronës, duke qenë në lajthitje nuk është arsye ligjore që paditësi të privohet nga prona, ndërsa kontraktuesi tjetër të përfiton në mënyrë të kundërligjshme nga kjo situatë”.*

25. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara, si dhe të konfirmohet fakti se paditësit Ivica Milošević, i është shkelur e drejta e pronës.
26. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të “vërteton faktin se me Aktgjykimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, të Kolegjit të Apelit, AC-I-17-0402 datë 22 shkurt 2018 dhe të Kolegjit të Specializuar, C-III-12-1986 të datës 21.06.2017, është shkelur e drejta në pronë e paditësit - palës Ivica Milošević, e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të bëhet anulimi i tërësishëm i këtyre dy aktgjytimeve”.
27. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të vendosë masën e përkohshme, duke arsyetuar: “kërkojmë që ndaj të paditurës NSH „Kosova Export“, Bujqësia, Fushë Kosovë, tani në likuidim, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, të caktohet Masa e përkohshme, ashtu që Agjencia Kosovare e Privatizimit të parandalohet që të shes apo të disponoj në çfarëdo mënyre me asetet në përbërje të tokës bujqësore – Ngastra kadastrale nr. 1338/2 Zona Kadastrale Laplla Sellë, në vendin e quajtur „Grmanje“, klasa e 4, me sipërfaqe prej 3606 m², deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës”.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI MBI MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE

"Gazeta zyrtare e RSFJ", nr. 29/78
1 tetor 1978

[...]

Nënpjesa 2
Koha që nevojitet për parashkrimin
Afati i përgjithshëm i parashkrimit

Neni 371

Kërkesat parashkruhen për pesë vjet në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

„1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

30. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç parashihet me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] i 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

31. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesën në cilësi të palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin (AC-I-17-0402) e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së të 22 shkurtit 2018, duke qartësuar saktësisht nenin e Kushtetutës për të cilin konsideron se është shkelur, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj. Parashtruesi gjithashtu e parashtrroi kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
32. Megjithatë, Gjykata shqyrton gjithashtu nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriterin e pranueshmërisë të përcaktuar në rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta e pronës.
34. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës përsërit të njëjtat argumente që ai kishte parashtruar në procedurat para DHPGJS-së, se Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së janë marrë me këtë çështje, prandaj Gjykata në paragrafët në vijim do t'i elaborojë më tej procedurat para DHPGJS-së.
35. Në rastin konkret, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit në lidhje me shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, përmbledhen në zbatimin dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së, duke ngritur kështu çështjen e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të dispozitave ligjore. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata *që të vlerësojë ligjshmërinë e vendimeve të kontestuara*, që bie ekskluzivisht në juridiksionin e gjykatave të rregullta (ligjshmëria).
36. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, si dhe interpretimi dhe zbatimi i ligjit janë në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta, dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (Shih, rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 29; shih, gjithashtu, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, të 5 prillit 2012).
37. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruesit përkitazi me të drejtën e pronës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjen se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së në Aktgjykimin C-III-12-1986 vërtetoi se pretendimet, bazuar në ligjin e zbatueshëm nga periudha në të cilën është lidhur kontrata e kontestuar, janë parashkruar, përkatësisht se afati për paraqitjen e padisë së tillë ka skaduar.
38. Sidoqoftë, Gjykata gjithashtu vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së i është përgjigjur parashtruesit lidhur me pretendimet se pala kundërshtarë nuk i kishte përmbushur obligimet e parashikuara me kontratën kontestuese, duke arsyetuar se *„kontrata nuk përmban dispozitën se e Paditura është e obliguar të kujdeset për regjistrimin e pronës së kontestuar në Kadastër. Sipas rregullit të përgjithshëm, i përbashkët nga ky PS-së çdo palë përkatëse duhet të kujdeset për interesat e veta, paraardhësi i paditësit është dashur të bëjë regjistrimin e pronës së kontestuar në librat kadastral. Me fjalë të tjera: paditësi është dashur të kujdeset që regjistrimi Kadastral i pronës së kontestuar të bëhet në emrin e tyre”.*
39. Gjykata gjithashtu vëren se sa i përket pretendimeve të parashtruesit lidhur me të drejtën e pronës, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së i dha përgjigje parashtruesit, duke arsyetuar se *„paditësi kontratën mbi ndërrimin e patundshmërive nuk mund ta përdorë si titull pronësor për të kërkuar ngastrën nr. 1338/2, e cila*

ngastër me këtë kontratë veç i është dhënë NSH-së së paditur, pasi që deri tani nuk ka asnjë aktgjykim të formës së prerë që vërteton se është shkëputur kjo kontratë”.

40. Lidhur me këtë, Gjykata gjen se në pajtim me rregullativën relevante ligjore nga periudha kur është lidhur kontrata, afati i përgjithshëm për paraqitjen e padisë për anulimin e kontratës së kontestuar ka skaduar.
41. Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së nuk garantojnë të drejtën për fitimin e pronës (Shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
42. Më tej, parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së vetëm për atë që vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me "*pasurinë*" e tij; brenda kuptimit të kësaj dispozite "*pasuria*" mund të jetë "*pasuria ekzistuese*", duke përfshirë edhe pretendimet, në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë "*prishmëri legjitime*" që do të fitojë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte të pronësisë.
43. Nuk mund të thuhet se lind ndonjë "*prishje legjitime*" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesat e parashtruesve janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (Shih, *Kopecký kundër Sllovakisë*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së i 28 shtatorit 2004, paragrafi 50).
44. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë dëshmi *prima facie*, dhe as nuk i ka mbështetur pretendimet se si dhe pse me vendimin e kontestuar i është shkelur e drejta e pronës e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
45. Si përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

Vlerësimi i kërkesës për masë të përkohshme

46. Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme.
47. Për ta miratuar masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 57 (5) të Rregullores, Gjykata duhet të konstatojë që:

“(5) Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Gjykata do të refuzojë kërkesën për masë të përkohshme.”

48. Siç është konkluduar më parë, kërkesa është e papranueshme, prandaj nuk ekziston rasti *prima facie* për vendosjen e masës së përkohshme. Për këto arsye, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, rregullin 39 (2) (d) dhe 57 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 shtator 2019, njëzëri

VENDOSI

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Safet Hoxha

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi